

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar  
Advanced Financial Reporting

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data  
09.06.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u></b>
1. Problemi 1	30	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	15	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Pasqyrat e konsoliduara në vijim kanë të bëjnë me grupin Dea sh.a për vitin e përfunduar me 31 maj 2018.

### Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar me 31 maj 2018

	€'000
Të hyrat	1,180
Kosto e shitjeve	<u>(442)</u>
Fitimi bruto	738
Të hyrat tjera	20
Kostot e shpërndarjes	(333)
Kostot administrative	(265)
Kosto financiare	(45)
Pjesa e humbjes së ortakërisë	<u>(60)</u>
Fitimi para tatimit	55
Tatimi	<u>(22)</u>
<b>Fitimi për periudhën</b>	<b>33</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	
Neto përfitimi aktuarial (vlerësimi të ekspertit)	<u>4</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>37</b>
<i>Fitimi i periudhës i atribuar:</i>	
Mbajtësve të ekuitetit të prindit	26.40
Interesit jo-kontrollues	<u>6.60</u>
	33.00
<i>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar::</i>	
Mbajtësve të ekuitetit të prindit	30.40
Interesit jo-kontrollues	<u>6.60</u>
	37.00

**Pasqyra e Konsoliduar e Pozites Financiare me 31 maj**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>		
<i>Jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	800	700
Zëri i mirë	88	90
Investimi në ortakëri	142	150
Tatimi i shtyrë	<u>-</u>	<u>10</u>
	1,030	950
<i>Qarkulluese</i>		
Stoqet	100	86
Të arkëtueshmet tregtare	140	146
Paraja & ekuivalentët e parasë	<u>-</u>	<u>13</u>
	240	245
<b>Total Pasuritë</b>	<b>1,270</b>	<b>1,195</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<b>Ekuiteti</b>		
Aksione të zakonshme prej €0.50 secila	330	220
Premia e aksioneve	66	16
Fitimet e mbajtura	(9)	(24)
	387	212
Interesat jo-kontrollues	<u>127</u>	<u>116</u>
<b>Total Ekuiteti</b>	<b>514</b>	<b>328</b>
<b>Detyrimet</b>		
<i>Afatgjata</i>		
Përfitimet e punonjësve	224	298
Tatimi i shtyrë	17	-
20% Nota krediti	<u>232</u>	<u>340</u>
	473	638
<i>Afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	130	134
Tatimi	29	47
Kosto financiare e pagueshme	80	48
Mbiterheqja bankare	<u>44</u>	<u>-</u>
	<u>283</u>	<u>229</u>
<b>Total Detyrimet</b>	<b>756</b>	<b>867</b>
<b>Total Ekuiteti dhe Detyrimet</b>	<b>1,270</b>	<b>1,195</b>

### **Informatat në vijim janë të rendësishme:**

- (1) Me 31 maj 2018, Dea sh.a bleu 80% të aksioneve të zakonshme të Lea sh.a për një konsideratë në para prej €126,000. Vlera e drejtë e neto pasurive të Lea sh.a në blerje ishte €14,000 e cila është përmbledhur më poshtë:

	<b>€'000</b>
Prona, fabrika dhe paisjet	13.60
Të arkëtueshmet tregtare	1.70
Banka	1.20
Të pagueshmet tregtare	(2.00)
Tatimi	<u>(0.50)</u>
	<b>14.00</b>

Nuk ka pasur shitje të filialeve gjatë vitit deri me 31 maj 2018.

- (2) Dea sh.a bleu edhe 10% aksione të zakonshme në Tea sh.a për një konsideratë në para prej €14,000 me 31 maj 2018. Kjo ka rritur pronësinë në 80%. Dea sh.a bleu 70% të aksioneve të zakonshme në Tea sh.a me 1 qershor 2015 për një konsideratë prej €89,000. Vlera e drejtë e neto pasurive të Tea sh.a ishte €130,000 dhe €10,000 me 31 maj 2018 dhe 1 qershor 2015 respektivisht. Zëri i mirë në Tea sh.a nuk është dëmtuar që nga blerja. Lëvizjet në ekuitet që rrjedhin nga ky transaksion janë dërguar tek premia e aksioneve.
- (3) Dea sh.a blu 25% të aksioneve të zakonshme në Zea sh.a me 1 nëntor 2017 për një konsideratë në para prej €72,000. Dea sh.a ka ndikim domëthënës në Zea sh.a. Dea sh.a ka pranuar dividenda totale prej €8,000 nga të gjitha kompanitë ortakëri për vitin deri me 31 maj 2018. Nuk është shitur asnjë investim në kompanitë ortakëri gjatë vitit.
- (4) Me 30 mars 2018, Dea sh.a shiti paisje me vlerë bartëse prej €38,000 për €58,000 në para. Me 1 prill 2018, Dea sh.a shiti një fabrikë për €6,000 në para. Ajo kishte vlerë bartëse prej €7,000. Zhvlerësimi i vitit ishte €68,000. Kjo është përfshirë në kostot e shitjeve. Për më tepër, fitimi nga shitja e paisjeve është dërguar tek të hyrat tjera përderisa humbja nga shitja e fabrikës është përfshirë në kostot administrative
- (5) Dea sh.a filloi me një plan të përfitimeve të paracaktuara me 1 qershor 2015. Gjatë vitit deri me 31 maj 2018, ka paguar kontribute të pensionit prej €100,000. Asnje përfitim i pensionit nuk është paguar gjatë vitit. Neto shpenzimet e pensionit janë përfshirë në kostot administrative. Neto përfitimet aktuariale (vlerësimi të ekspertit) janë përfshirë në preminë e aksioneve.

- (6) Zëri i mirë i konsoliduar dhe investimet në ortakëri janë dëmtuar që të dyjat gjatë vitit deri me 31 maj 2018, me përjashtim në zërit të mirë në Tea sh.a në (2) më lartë.
- (7) Nota e kreditit 20% është emetuar me 1 qershor 2016. Është klasifikuar si duhet si 'detyrim financiar nepermjet fitimit ose humbjes'. Të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë janë përfshirë në shpenzimet administrative. Nuk ka pasur shitje apo blerje të detyrimeve financiare të klasifikuara si 'nepermjet fitimit ose humbjes' gjatë vitit.
- (8) Dea sh.a emetoi aksione të zakonshme për para me 31 dhjetor 2017.
- (9) Dea sh.a, filialet e saj dhe kompanitë ortakëri paguan dividenda me 1 dhjetor 2017.
- (10) Është politikë e grupit Dea sh.a të vlerësoj interesin jo-kontrollues duke përdorur metoden proporcionale të pasurive neto.

**Kërkohet:**

- (a) **Përgadite pasqyrën e konsoliduar të rrjedhes së parasë për grupin Dea sh.a duke përdorur metoden indirekte për vitin e përfunduar me 31 maj 2018 në pajtim me kërkesat e SNK 7 Pasqyra e rrjedhes së parasë. (Shënimet e pasqyrës së rrjedhes së parasë nuk kërkohen). (30 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 1

### Grupi Dea

#### Pasqyra e konsoliduar e rrjedhes së parasë për vitin e përfunduar me 31 maj 2018

	€'000	€'000
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi para tatimit		55.00
Shto:		
Pjesa e humbjes së ortakërisë		60.00
Kosto financiare		45.00
Zhvlerësimin		68.00
Neto shpenzimet e pensioneve L19		30.00
Humbja nga shitja e fabrikës (6 -7)		1.00
Fitimi në shitjen e paisjes (58 -38)		(20.00)
Rënia në vlerën e drejtë të notës së kreditit (340 - 232)		(108.00)
Dëmtimi i zërit të mirë L12		116.80
Dëmtimi i investimit në ortakëri L13		12.00
Rritja në stoqe (100 - 86)		(14.00)
Zvogelimi në të arkëtueshmet tregtare (140 -146 - 1.7)		7.70
Rritja në të pagueshmet tregtare (130 - 134 - 2)		(6.00)
Paraja e gjeneruar nga operacionet		247.50
Kontributet e pensioneve të paguara		(100.00)
Tatimi i paguar L14		(13.50)
Interesi i paguar L110		<u>(13.00)</u>
Neto hyrjet e parasë nga aktivitetet operative		<b>121.00</b>
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</i>		
Blerja e Lea sh.a (126 - 1.2)	(124.80)	
Blerja e aksioneve në Tea sh.a	(14.00)	
Blerja e aksioneve në Zea sh.a	(72.00)	
Blerja e PFP L11	(199.40)	
Arkëtimet nga shitja e PFP (58+6)	64.00	
Dividenda e pranuar nga ortakëritë	<u>8.00</u>	
Neto daljet e parasë nga aktivitetet investuese		<b>(338.20)</b>

<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve L16	157.00	
Paraja e pranuar nga IJK L18	14.60	
Dividendat tjera të paguara L17	<u>(11.40)</u>	
Neto rrjedhat hyrëse nga aktivitetet financuese		<b>160.20</b>

Zvogëlimi në paranë & ekuivaletët e parasë		(57.00)
Paraja & ekuivaletët e parasë në fillim		13.00
Paraja & ekuivaletët e parasë në fund		(44.00)
Llogaritjet		

#### **L11**

<b>Prona, fabrika dhe paisjet</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	700.00
Zhvlerësimi	(68.00)
Filiali i ri	13.60
Shitjet (38+7)	(45.00)
Blerjet (shif. bal.)	<u>199.40</u>
Saldo në fund	800.00

#### **L12**

<b>Zëri i mirë</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	90.00
Filiali i ri 126 - (80% x 14)	114.80
Dëmtimi (shif. bal.)	<u>(116.80)</u>
Saldo në fund	88.00

#### **L13**

<b>Investimet në ortakëri</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	150.00
Blerjet	72.00
Pjesa e humbjes	(60.00)
Shitjet	-
Dëmtimi (shif. bal.)	(12.00)
Dividenda e pranuar	<u>(8.00)</u>
Saldo në fund	142.00



<b>L14</b>	
<b>Tatimi</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim (47 - 10)	37.00
Fitimi ose humbja	22.00
Filiali i ri	0.50
Paraja e paguar (shif. bal.)	<u>(13.50)</u>
Saldo në fund (29+17)	46.00

<b>L15</b>	
<b>Levizjet në ekuitet - 10% pronësi</b>	<b>€'000</b>
IJK me 31 maj 2018 para largimit (30% x 130)	<u>39</u>
Zvogëlim i IJK-së 10/30 x 39	13
Konsiderata e paguar	<u>14</u>
Levizjet negative në ekuitet	(1)

<b>L16</b>	
<b>Emetimi i aksioneve</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim (220 + 16)	236.00
Neto përfitimi aktuarial (vlerësim të ekspertit)	4.00
Aksionet e emetuara për para(shif. bal.)	157.00
Levizjet në ekuitet L15	<u>(1.00)</u>
Saldo në fund (330 + 66)	396.00

<b>L17</b>	
<b>Fitimet e mbajtura</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	(24.00)
Fitimi ose humbja	26.40
Dividenda e paguar (shif. bal.)	<u>(11.40)</u>
Saldo në fund	(9.00)

<b>L18</b>	
<b>Interesat jo-kontrollues</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	116.00
Filiali i ri 20% x 14	2.80
Fitimi ose humbja	6.60
Zvogëlim në IJK L15	(13.00)
Paraja e pranuar (shif. bal.)	<u>14.60</u>
Saldo në fund	127.00

**L19**

<b>Përfitimet e punonjësve</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	298.00
Neto përfitimi aktuarial (vlerësimi të ekspertit)	(4.00)
Neto shpenzimet e pensioneve (shif. bal.)	30.00
Kontributet e paguara	<u>(100.00)</u>
Saldo në fund	224.00

**L110**

<b>Interesi i pagueshëm</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	48.00
Fitimi ose humbja	45.00
Paraja paguar (shif. bal.)	<u>(13.00)</u>
Saldo në fund	80.00

## Problemi 2

Ju punoni për Prishtina Finance si një këshilltar financiar i kompanisë. Dy klientë të juaj të mëdhenj Ulpiana sh.a dhe Dardania sh.a kanë kërkuar këshillë nga ju lidhur më trajtimin në kontabilitet të çështjeve në vijim në pasqyrat e tyre financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### Klienti 1-Ulpiana sh.a

(8 pikë)

Ulpiana sh.a bleu një makineri për prodhimin e tjegullave me 1 prill 2017 me një kosto prej €400,000. Makinaria kualifikohet për një grant të menjëhershëm qeveritar në 10% të çmimit të saj të blerjes dhe zbritjeve tregtare me kusht që të përdoret përgjatë jetës së përdorimit. Granti është pranuar nga Ulpiana sh.a me 1 prill 2017. Makinaria ishte e gatshme për përdorim me 1 korrik 2017.

Kosto prej €400,000 përbëhej nga:

	€'000
Çmimi i blerjes (shënim 1)	300
Kosto e instalimit (shënim 2)	70
Kosto e garantimit të performances (shënim 3)	20
Kosto e transportit (shënim 4)	<u>10</u>
<b>Total kosto</b>	<b>400</b>

### Shënime

- (1) Çmimi i blerjes është para zbritjeve tregtare prej 8%.
- (2) Instalimi është bërë edhe nga furnitori edhe nga stafi i Ulpiana sh.a-së. €26,000 e kostove të paraqitura më sipër kanë të bëjnë me shumën të cilën furnitori ia ka paguar Ulpiana sh.a-së për punët e instalimit të kryera nga stafi i saj. Ulpiana sh.a nuk i ka paguar punëtorët e saj me ndonjë shumë tjetër për përfshirjen në instalimin e makinerisë së re.
- (3) Kjo ka të bëjë me shërbimet e mirëmbajtjes dy vjeçare që jipen nga furnitori. Është paguar me 1 prill 2017. Është e rimbursueshme nëse nuk kryhet asnjë shërbim për makinë. Asnje shërbim nuk është kryer nga furnitori deri në periudhën e përfunduar me 31 mars 2018.

- (4) Kjo është thjesht një vlerësim i shumës që do të ishte kërkuar nga furnitori për transportin e makinerisë. Makina megjithatë është transportuar pa pagesë pasi që ishte në promocion.

Ulpiana sh.a zhvlerëson makinerinë me një normë prej 20% në vit. Supozo zero vlerë të mbetur. Ulpiana sh.a ka një politikë të përdorimit të të hyrave të shtyera për kontabilizimin e granteve qeveritare.

Drejtorët e Ulpiana sh.a-së kërkojnë këshillën tuaj se si ky transaksion duhet të trajtohet në pasqyrat e tyre financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2018.

**Klienti 2 - Dardania sh.a**

**(7 pikë)**

Drejtori Menaxhues i Dardania sh.a, i cili nuk është kontabilist, se fundi kishte qenë në një seminar dhe kërkon sqarime për çështjen në vijim që është diskutuar në seminar;

Njëri nga delegatët në seminar, drejtor i një entiteti që operon një numër të fermave të ndryshme, informoi të pranishmit që ekziston një Standard Ndërkombëtar i Raportimit Financiar që aplikohet tek entitetet që mirren me ferma, SNK 41 *Agrikultura*.

Drejtori menaxhues i Dardania sh.a-së tani dëshiron të dijë përse një standard i veçantë është i nevojshëm për entitetet që mirren me ferma. Ai shton me tutje: “duke qenë se kemi SNK 41, a nënkupton kjo që SNRF-të tjera nuk aplikohen te entitetet që mirren me ferma? Ju lutem shpjegoni kërkesat kryesore të njohjes dhe matjes të SNK 41 pa e mundur veten me detajet që lidhen me shpalosjet”. Drejtori menaxhues është i interesuar në çfardo fushe ku kërkesat e SNK 41 dallojnë nga SNRF-të tjera në përgjithësi. Drejtori menaxhues konkludon duke thënë që ai beson se ka degjuar se entitetet që mirren me ferma i trajtojnë grantet qeveritare ndryshe nga entitetet tjera dhe ai është i interesuar në veçanti për sqarim të kësaj.

**Kërkohet:**

**Ktheju përgjigje pyetjeve të ngritura nga drejtorët e dy kompanive klientë. (total 15 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

### Klienti 1 - Ulpiana sh.a

Makineria për prodhimin e tjegullave duhet fillimisht të njihet në pajtim me SNK 16 *Prona, Fabrika dhe paisjet*. Kosto e saj fillestare duhet të përbëhet nga çmimi i blerjes minus zbritjet tregtare nese ka ndonjë. Kësaj shifre duhet t'i shtohen edhe kostot e sjelljes së makinerisë në lokacionet e Ulpiana sh.a dhe në kushtet për të punuar.

Makineria do të njihet tek pasuritë jo-qarkulluese sipas vlerës bartëse prej €272,000 L11 në pasqyrën e pozitës financiare të Ulpiana sh.a-së me 31 mars 2018. Kjo është arritur pas shtimit të koston së instalimit prej €44,000 L11 bazuar në koston e paguar nga Ulpiana sh.a. €24,000 që i është paguar Ulpiana sh.a-së nga furnitori për ndihmen në instalimin e makinerisë është një e hyrë për Ulpiana sh.a dhe duhet të trajtohet si e tillë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Në fund, zbritjet tregtare prej €24,000 L11 dhe ngarkesa për zhvlerësim për periudhën nëntë mujore prej €48,000 L11 duhet të zbriten për të llogaritur vlerën bartëse. Ngarkësa e zhvlërësimit duhet të shpenzohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 mars 2018.

Shuma e paguar për garantim të performances në vlerë prej €20,000 duhet të trajtohet si parapagim në pasqyrën e pozitës financiare të Ulpiana sh.a-së me 31 mars 2018 te pasuritë jo-qarkulluese. Një shumë e barabartë me vlerën e punëve të riparimit të kryera nga furnitori duhet të shpenzohet në pasqyrën e të fitimit ose humbjes dhe po ajo shumë duhet të transferohet nga €20,000. Asnjë shumë nuk transferohet nga pasqyrat e fitimit ose humbjes e as nuk shpenzohet për vitin e përfunduar me 31 mars 2018 pasi që asnjë punë e riparimit nuk është kryer nga furnitori në makinerinë për vitin e përfunduar me 31 mars 2018.

Granti qeveritar prej €27,600 L12 do të shpërndahet njëtrajtërisht përgjatë jetës ekonomike të makinerisë prej 5 viteve. Kjo është në pajtim me qasjen e të hyrave të shtyera në SNK 20 *Kontabiliteti për grante qeveritare dhe ndihmat qeveritare*. Megjithatë, periudha deri me 31 mars 2018 është vetëm nëntë muaj. Andaj, €4,140 L12 do të transferohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 mars 2018. Kjo do të lërë saldon e të hyrave të shtyera që ka të bejë me grantet qeveritare prej €23,460 L12 të regjistruara tek detyrimet në pasqyrën e pozitës financiare me 31 mars 2018. Kjo shumë do të ndahet në detyrimet afatgjata prej €17,940 L12 dhe detyrimet afatshkurtëra prej €5,520 L12.

## Llogaritjet

### L11 - Makineria për prodhimin e tjegullave

	€'000
Çmimi i blerjes	300
Minus: zbritje tregtare @8%	<u>(24)</u>
Neto çmimi i blerjes	276
Shto: koston e instalimit (70 - 26)	<u>44</u>
<b>Total kosto fillestare</b>	<b>320</b>
Zhvlerësimi (20% x 320) x 9/12	<u>(48)</u>
<b>Vlera bartëse me 31 mars 2018</b>	<b>272</b>

### L12 - Granti qeveritar

	€'000
Çmimi neto i blerjes (L13)	276.00
Granti @10%	27.60
Transferuar tek Fitim ose humbje (27.6/5 vite) x 9/12	(4.14)
Saldo me 31 mars 2018	<u>23.46</u>
<b>Detyrimi afatshkurtër (27.6/5 vite)</b>	<b>5.52</b>
<b>Detyrimi afatgjatë</b>	<b>17.94</b>

## Klienti 2 - Dardania sh.a

Nuk është e vërtetë që pasi që ekziston SNK 41 *Agrikultura* - SNRF-të tjera nuk aplikohen tëk enitete që mirren me ferma. Kërkesat e paraqitjes së pasqyrave financiare të SNK 1 *Prezantimi i Pasqyrave Financiare*, së bashku me kërkesat specifike të njohjes dhe matjes së SNRF-ve tjera, aplikohet tek kompanitë që mirren me ferma po aq sa tek kompanitë tjera.

SNK 41 ka të bëjë me aktivitetet agrikulturore. Dy përkufizime kyqe që janë dhënë në SNK 41 janë pasuritë biologjike dhe prodhimi agrikulturor.

Një pasuri biologjike është një kafshë e gjallë apo bimë. Shembuj të pasurive biologjike do të ishin, delet dhe pemët e frutave. Kriteret për njohjen e pasurive biologjike janë konsistente me SNRF-të tjera, dhe bazohen në përkufizimin e një pasurie sipas Kornizës.

Një çështje kyqe me të cilën merret SNK 41 është matja e pasurive biologjike. Duke pasë parasysh natyrën e tyre (p.sh. qingjat që lindin nga delet të cilat janë pasuri ekzistuese), përdorimi i koston si bazë e matjes është i papërshtatshëm.

Kërkesë e SNK 41 për pasuri biologjike është matja e tyre sipas vlerës së drejte minu koston e shitjes. Ndryshimet në vlerën e drejtë minus koston e shitjes nga një periudhë në tjetren njihen në fitim ose humbje.

Prodhimi agrikulturor është prodhimi i vjelur/korrur/mbledhur nga një pasuri biologjike. Shembuj do të ishin leshti (nga delja) apo frutat (nga pema).

Çështja e matjes së 'kostos' së një pasurie të tillë është e ngjajshme me atë të pasurive biologjike. SNK 41 andaj kërkon që 'kosto' duhet të jetë vlera e drejtë minus kostot e shitjes në pikën e vjeljes/korrjes/mbledhjes. Kjo shifër pastaj do të jetë kosto për qëllim të SNK 2 *Stoqet*.

Si pasojë e trajtimit më sipër është që grantet qeveritare sa i përket pasurive biologjike nuk trajtohen në mënyrën e përshkruar nga SNK 20 *Grantet qeveritare*. Kur një grant i tillë është i pakushtëzuar, duhet të njihet në fitim ose humbje kur të bëhet i arkëtueshëm. Nëse granti ka kushte, duhet të njihet në fitim ose humbje vetëm kur kushtet janë përmbushur.

Trajtimi i granteve sipas SNK 20 është që të njihen ato në fitim ose humbje siç njihen edhe shpenzimet me të cilat ndërliken ato. Kjo nënkupton që njohja e grantit që ka të bëjë me pronën, fabrikën edhe paisjet duhet të ndodhë përgjatë jetës së pasurisë e jo kur përmbushen kushtet për përfitimin e grantit.

### Problemi 3

Celulari sh.a është një importues dhe shitës me shumicë i aksesorve të telefonave mobil dhe mallrave që kanë lidhje më to. Pasqyrat e përmbledhura financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2018 (dhe informatat krahasuese të vitit 2017) janë si në vijim:

#### Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitet e përfunduara me 31 mars:

	2018 €milion	2017 €milion
Të hyrat	275	150
Kosto e shitjeve	<u>(100)</u>	<u>(30)</u>
Fitimi bruto	175	120
Kostot operative	(50)	(30)
Të hyrat nga investimet	12	12
Kostot e financimit	<u>(50)</u>	<u>(15)</u>
Fitimi (humbja) para tatimit	87	87
Tatimi në fitim	<u>(10)</u>	<u>(10)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>77</b>	<b>77</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (shumat që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje):		
Fitimet nga vlera e drejtë e investimeve në ekuitet	30	5
Humbja nga rivlerësimi i pronës, fabrikës & paisjeve	<u>(45)</u>	<u>-</u>
<b>Total të ardhurat (humbjet) gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>62</b>	<b>82</b>

#### Pasqyrat e pozitës financiare me 31 mars:

	2018 €milion	2017 €milion
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	1,198	677
Pasuritë e paprekshme – franshiza	20	-
Investimet në ekuitet të përcaktuara “vlera e drejtë nëpërmjet TTGJ”	<u>170</u>	<u>140</u>
	1,388	817
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	40	19
Të arkëtueshmet tregtare	52	28
Banka	<u>40</u>	<u>10</u>
	<u>132</u>	<u>57</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,520</b>	<b>874</b>



	<b>2018</b>	<b>2017</b>
	<b>€milion</b>	<b>€milion</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<i>Ekuiteti:</i>		
Aksionet e ekuitetit prej €1 secila	180	120
Premia e aksioneve	60	--
Komponentë të tjerë të ekuitetit	40	55
Fitimet e mbajtura	<u>400</u>	<u>350</u>
	680	525
 <i>Detyrimet afatgjata:</i>		
Kredi nga banka	750	300
 <i>Detyrimet afatshkurtera:</i>		
Të pagueshmet tregtare	30	9
Akrualet tjera	50	30
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>10</u>	<u>10</u>
	90	49
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>1,520</b>	<b>874</b>

Me 1 prill 2017, drejtorët e Celulari sh.a vendosen të zgjerojnë biznesin duke blerë një franshizë për të importuar dhe shpërndarë linja shtesë të produkteve. Franshiza kushtoi €25 milion dhe kishte jetegjatësi prej pesë viteve. Megjithatë, mund të rinovohet me një tarife shtesë, varësisht nëse performaca është e kënaqshme.

Biznesi i ri kërkoi investime të mëdha në depo dhe mjete motorike të shpërndarjes. Për të financuar këtë zgjerim, aksione shtesë janë emetuar dhe kredia ekzistuese bankare u zëvendësua më një më të madhe. Banka ngarkoi një normë më të lartë të interesit në kredinë e re për shkak të leverazhit më të lartë që rezultoi nga nivelet më të larta të borxhit. Kapitali i ri është emetuar me 1 prill 2017, dhe kredia është e ripagueshme me 31 mars 2023.

Gjatë një takimi të bordit të mbajtur për të rishikuar performancën e vitit, disa drejtorë shprehen pakënaqësi me rezultatet financiare, duke theksuar se përkundër rritjes së madhe të të hyrave, fitimet për vitin kanë postuar rritje zero, dhe total të ardhurat gjithëpërfshirëse janë zvogëluar për €20 milion.

Drejtori financiar u pajtua që rezultati ishte dëshpërues për vitin e përfunduar në mars 2018. Ai paraqiti disa informata për të cilat mendoi që mund të ndihmojnë në analizimin e shkakut të rezultateve të dobëta dhe trendeve të mundshme të performancës së ardhshme të biznesit. Ai gjithashtu përmendi këto pika:

- Gjatë vitit të përfunduar me 31 mars 2018 linjat para-ekzistuese të prodhimit (të cilat nuk përfshinin zgjerimin) raportuan të hyra prej €175 milion, kosto të shitjeve prej €33 milion dhe shpenzime operative prej €28 milion.
- Ka patur probleme në prodhim tek prodhuesi i disa produkteve të reja, duke shpër në mangësi të furnizimeve. Celulari sh.a-së i është dashur të blejë produktet nga një furnitor tjetër me një kosto më të lartë për të përmbushur dergesat e kontraktuara. Kjo ka shtuar €22 milion tek kosto e shitjeve gjatë periudhës. Problemet tani janë zgjidhur dhe nuk pritet të shfaqen përsëri.
- Dividenda prej €0.15 për aksion ishin paguar me 31 mars 2018, në pajtim me një vendim të mëhershëm të bordit. Kjo shumë për aksion ishte e njejtë me atë të vitit të kaluar.

**Kërkohe:**

**Përgadite një raport për të rishikuar brengat e drejtorëve të pakënaqur duke përdorur koeficientët e duhur dhe informatat mësipër. Raporti i juaj duhet të japë rekomandime, aty ku është e duhur, për të adresuar brengat.**

**(Total: 20 pikë)**

### Zgjidhja e problemit 3

#### LLogaritja e koeficientëve

	v/p 31 mars 2017	v/p 31 mars 2018	2018 korigjuar
Marzha bruto	$120/150 = 80\%$	$175/275 = 63.6\%$	$(175+22)/275 = 71.6\%$
Marzha neto	$102/150 = 68\%$	$137/275 = 49.8\%$	$(137+22)/275 = 57.8\%$
KNKA	$102/(525+300) = 12.4\%$	$137/(750+680) = 9.6\%$	$(137+22)/(750+680) = 11.1\%$
KE	$77/525 = 14.7\%$	$77/680 = 11.3\%$	$(77+22-2.5)/680 = 14.2\%$
Koefic. qark.	$57:49 = 1.16:1$	$132:90 = 1.47:1$	n/a(ska ndryshim)
Testi acidik	$(57-19):49 = 0.78:1$	$(132-40):90 = 1.02:1$	n/a
Ditët e stoqeve	$19/30*365 = 231$ ditë	$40/100*365 = 146$	$40/(100-22)*365 = 187$
Ditët e LL/A	$28/150 * 365 = 68$ ditë	$52/275 * 365 = 69$	n/a
Ditët e LL/P	$9/30*365 = 109$ ditë	$30/100*365 = 109$	$30/(100-22)*365 = 140$
Leverazhi	$300/525 = 57\%$	$750/680 = 110\%$	$750/(680+22-2.5) = 107\%$

#### Raport:

Për: Drejtorët e Celulari sh.a

Nga: Filan Fisteku, Kontabilist

Tema: Analiza e performaces së Celulari sh.a për vitin e përfunduar me 31 mars 2018.

Data: 30 prill 2018.

Të ndëruar drejtorë,

Kam kënaqësinë të ju prezantoj raportin tim të përformances së kompanisë tuaj gjatë vitit të kaluar. Kam bërë krahasimin me vitin e kaluar, dhe kam tentuar projektimet duke u bazuar në informatat e dhëna nga ju.

Do të adresoj përformancën nën titujt në vijim, të cilët janë të zakonshëm për këtë lloj të raportit. Këto janë:

- Profitabiliteti;
- Likuiditeti; dhe
- Efiçienca.

Llogaritjet dhe të dhënat mbështetese janë dhënë në shtojcë të raportit, nese dëshironi të i referoheni.

## **Profitabiliteti**

Gjëja e parë që duhet të dihet është që Celulari sh.a ka fitime të larta në të gjitha parametrat standard.

Marzha bruto dhe marzha neto janë jashtëzakonisht të larta, dhe nëse biznesi rritet siç është parashikuar, kjo do të shpie në rritje të shpejta të fitimeve. Marzha bruto ishte 80% në 2017, duke rënë në normë akoma të shkëlqyer prej 64% në 2018. Duke lejuar për koston e papersëritshme që ndodhi në vitin 2018, dhe duke supozuar që kjo nuk do të ndodhte, marzha bruto do të ishte afër 72%. Edhe pse është rënie krahasuar me vitin 2017, duhet të ceket që vëllimet më të larta me një marzhë prej 72% do të rezultojnë me fitime më të larta së vëllimet e ulëta me marzhë 80%. Andaj nuk është gjë e keqe rena e marzhave përderisa vëllimet rriten, dhe përderisa fitimet shtesë tejkalojnë marzhën e ulët. Edhe pse kjo nuk ka ndodhur në vitin 2018, është e arsyeshme të projektohet që kjo do të ndodh në të ardhmen, pasi që çështjet e furnizimit do të sqarohen dhe vëllimet të vazhdojnë me rritjen e pritur.

Kthimi në kapitalin e angazhuar është i arsyeshëm, edhe pse jo impresionues. Duket se për nga natyra e biznesit tuaj, dhe nga diskutimet me drejtorin tuaj financiar, ekziston kapaciteti i lartë për ta punësuar bazën ekzistuese të kapitalit, dhe rritur vëllimin e shitjeve në mënyrë substanciale. Kjo do të mundësojë rritje në kthimin e kapitalit.

Kthimi në ekuitet është më i lartë se KNKA, që tregon se biznesi i juaj është duke i përdorur fondet e huazuara në mënyrë efektive. Ky efekt vetëm se do të rritet basi që biznesi të zgjerohet.

## **Likuiditeti**

Likuiditeti i Celulari sh.a është përmirësuar dukshëm gjatë vitit të kaluar.

Koeficienti qarkullues është përmirësuar nga 1.16:1 në 1.47:1. Koeficienti i testit acidik gjithashtu është përmirësuar nga 0.78:1 në 1.02:1. Këto ndryshime i transformojnë koeficientët nga të përshtetësues në vitin 2017 në nivelet aktuale të përmirësuara.

Ky ndryshim është kryesisht për shkak të kapitalit të emetuar që kontribuoi €570m në fondet e kompanisë. Shumë prej kësaj është investuar në rritjen e ardhshme, por përderisa shumë biznese ballafaqohen me mungesë likuiditeti gjatë zgjerimit, si duket ju e keni menaxhuar shumë mirë këtë.

Likuiditeti afatgjatë matet me koeficientin e leverazhit. Ky ishte mjaft konservativ në vitin 2017, në 57%. Koeficienti (borxh/ekuitet) arriti në 110% në vitin 2018, për shkak të borxhit shtesë të marrë për zgjerimin në të ardhmen. Siç duket kjo ka shkaktuar edhe rritje të norms së interesit. Borxhi i vitit 2017 kishte normë prej 5% (15/300) përderisa borxhi i vitit 2018 është 6.7% (50/750). Kjo nënkupton që borxhi shtesë kishte normë prej 7.8% (50-15) / (750- 300) në vit. Kjo duket e arsyeshme duke pasur parasysh mundësinë në treg që i është hapur kompanisë.

Megjithatë, keni kujdes se edhe kthimi në kapital duhet gjithashtu ta tejkaloj atë normë, ose përndryshe biznesi do të humb para. Kjo mund të shkaktoj një rreth vicioz shumë lehtë. Vini re se kredia duhet të ripaguhet ose rinegociohet në vitin 2023. Kjo mund të krijoj një kurthë të likuiditetit nëse biznesi në nderkohë nuk performon siç është projektuar.

Në përgjithësi, duket se ka pak presion të likuiditetit në këtë kompani. Ka para të mjaftueshme për të paguar detyrimet kur ato të arrijnë.

### **Efiçienca**

Kjo është një fushë për të cilën rekomandoj që duhet të i kushtohet më shumë vëmendje. Duket se ka disa mangësi në menaxhimin e kapitalit qarkullues.

Ditët e stoqeve duket se janë të larta, edhe pse janë përmirësuar. Kjo mund të jetë për shkak të koheve të gjata të transportit që janë inhereente për modelin e biznesit tuaj. Megjithatë, unë rekomandoj që të ekzaminohet për të parë nëse mund të bëhen përmirësime.

Kjo me sa duket deri diku kompenzohet nga ditë më të gjata të të pagueshmeve. Nëse mallrat janë duke kaluar më shumë kohë në transport, dhe kompania e juaj ende nuk e ka bërë pagesën, kjo është neutrale për paranë. Do të ia vlen të shikohet nëse çmimi do të ishte më i lirë nëse mallrat do të paguheshin më heret. Kjo është shpesh një kosto e fshehur e ditëve me të gjata të të pagueshmeve, pasi që çmimi me i lartë se zakonisht mund të kërkohet nga furnitori.

Për ditët e të arkëtueshmeve, në anën tjetër, duket se nga menaxhimi më i mirë mund të përfitonte biznesi. 68-69 është më gjatë se sa normale të u lejohet klienteve të paguajnë për mallrat e blerë. Natyra e produktit është e tillë që mund të bëhet i pavlerë shumë shpejt. Nëse kjo ndodh, klientët mund ta kenë të vështirë të paguajnë për mallrat të cilët nuk iu shiten. Pasi që marzhat bruto janë aq të larta, mund të ketë hapësirë për të ofruar një zbritje për pagesë të mëhershme. Kjo do të paguante veten nepermjet interesit dhe borxhit më të ulët.

### **Parashikimi në të ardhmen**

Edhe pse fitimi për 2018 ishte i njejtë me 2017 përkudër shitjeve më të larta, kjo nuk është brengosese për mua. Gjatë ekzaminimit të shifrave tuaja, është shumë e qartë që kishte zëra që nuk përsëriten që ndikuan në performance në 2018. Unë kam rikalkuluar koeficientët kyç duke u bazuar që €22 milion në kostot ekstra të blerjes nuk do të përsëriten në 2018. Koeficientët e rishikuar tregojnë një performancë shumë më pozitive. Kam supozuar që €22 milion do të kursehen, sipas instruksioneve, dhe që kjo do të tatóhet me normen mesatare të kompanisë prej 11%.

Duke shikuar përpara në vitin 2019, nëse vëllimet e shitjes arrijnë rritje prej 20% siç është parashikuar, fitimi për vitin me shumë arsyeshmëri pritet të arrij €121 milion. Kjo është plotë

57% më shumë se sa përformanca e vitit 2018. Kjo do ta vendoste Celulari sh.a-në një një pozitë shumë të mirë financiare. Nëse kjo rritje mund të mbahet, shoh një të ardhme të ndritshme.

Nëse keni pyetje të tjera lirisht me kontaktoni në çdo kohë.

#### Problemi 4

Rea sh.a përgadit pasqyrat financiare me 31 mars çdo vit. Pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2018 do të autorizohen për tu publikuar me 30 qershor 2018. Ngjarjet në vijim janë relevante për këto pasqyrat financiare:

- (a) Me 1 prill 2017, Rea sh.a bleu 1 milion opcione për të blerë aksione në Bea sh.a, një kompani e listuar në bursë. Rea sh.a pagoi €0.25 për opcion, e cila i lejon Rea sh.a-së të blejë aksione në Bea sh.a për një çmim prej €2.00 për aksion. Data e ushtrimit të opcioneve ishte 31 dhjetor 2017. Me 31 dhjetor 2017, kur vlera e tregut e aksioneve në Bea sh.a ishte €2.60, Rea sh.a ushtroi të drejtën e të gjitha opcioneve të saj për të blerë aksione në Bea sh.a. Përveç çmimit të blerjes, Rea sh.a pagoi kosto direkte të blerjes prej €100,000 për blerjen e 1 milion aksioneve në Bea sh.a. Rea sh.a i konsideroi aksionet e blera në Bea sh.a si pjesë e portfolios së saj tregtare. Megjithatë, Rea sh.a nuk i ka shitur anjë nga këto aksione në Bea sh.a ndërmjet 31 dhjetor 2017 dhe 31 mars 2018. Me 31 mars 2018, çmimi i tregut të aksioneve në Bea sh.a ishte €2.90. **(9 pikë)**
- (b) Me 1 prill 2017, Rea sh.a shiti një pronë për €48 milion për të financuar zgjerimin e biznesit. Vlera bartëse e pronës me 1 prill 2017 ishte €50 milion dhe vlera e saj e drejtë ishte €55 milion. Jeta e vlerësuar e ardhshme e përdorimit të pronës me 1 prill 2017 ishte 40 vite. Me 1 prill 2017, Rea sh.a filloi që ta marrë me qira këtë pronë me një lizing 10 vjeçar. Qerate vjetore të lizingut për 5 vitet e para të lizingut ishin caktuar të jenë €1 milion. Për 5 vitet e fundit të lizingut, qiratë ishin caktuar të jenë €1.5 milion. Që të dy shumatat e qirasë ishin nën qiratë sipas tregut për një prone të natyrës së tillë. **(7 pikë)**
- (c) Me 31 mars 2018, stoqet e Rea sh.a përfshinin një konsignacion të komponentëve të cilat Rea sh.a ishte duke ia furnizuar një numri të klientëve që disa vite. Kosto e konsignacionit ishte €10 milion dhe e bazuar në çmimet me pakicë të datës 31 mars 2018, çmimi i pritur i shitjes së konsignacionit ishte €12 milion. Me 15 maj 2018, një konkurrent përfundoi zhvillimin e një komponenti alternativ i cili ka shumë gjasa që ta bëjë konsignacionin e Rea sh.a-së të pavlerë. Drejtorët e Rea sh.a-së vlerësuan që konsignacioni (i tëri akoma i pashitur) tani do të shitet për vetëm €2 milion. **(4 pikë)**

**Kërkohet:**

**Shpjego dhe trego se si të tri ngjarjet duhet të raportohen në pasqyrat financiare të Rea sh.a për vitin e përfunduar me 31 mars 2018. **(20 pikë)****

#### Zgjidhja e problemit 4

(a) Sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare*, opcionet për të blerë aksione në Bea sh.a duhet të trajtohen si një instrument financiar derivativ.

Kjo për arsye se vlera e opcionit varet nga vlera e një variable bazë (çmimi i aksionit në Bea sh.a), kërkon një investim fillestar relativisht të vogël dhe paguhet në një datë në të ardhmen.

Një instrument financiar derivativ matet fillimisht sipas vlerës së drejtë. Në këtë rast vlera e drejtë do të jetë çmimi i paguar - i cili është €250,000 me 1 prill 2017.

Instrumentet financiare derivative maten sipas vlerës së drejtë në datën e raportimit dhe fitimet ose humbjet në rimatje njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Megjithatë, në këtë rast derivativi ç'kontabilizohet me 31 dhjetor 2017, kur opsi i është ushtruar.

Me 31 dhjetor 2017, investimi në aksionet e Bea sh.a-së do të trajtohet si një pasuri financiare. Sipas SNRF 9, pasuritë financiare fillimisht maten sipas vlerës së drejtë, ashtu që vlera bartëse fillestare e aksioneve në librat e Rea sh.a-së do të jetë €2.6 milion (1 milion X €2.60).

Diferenca ndërmjet vlerës bartëse të pasurisë së re - €2.6 milion dhe çmimi i paguar plus ç'kontabilizimi i derivativit - €2.25 milion (€2 milion + €250,000) do të dërgohet në fitim ose humbje për vitin e përfunduar me 31 mars 2018 si e hyrë nga investimi. Në këtë rast €350,000 do të përfshihet si e hyrë nga investimi.

Duke qenë se investimi në Bea sh.a është një investim në ekuitet, do të vazhdoj të ri-matet sipas vlerës së drejtë në fund të secilit vit. Dhe duke qenë se investimi është pjesë e portofolios për tregtim, investimi matet sipas vlerës së drejtë nepermjet fitimit ose humbjes. Andaj kosto e blerjes prej €100,000 duhet të njihet si një shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 mars 2018.

Investimi është i përfshirë në pasqyrën e pozitës financiare me 31 mars 2018 si pasuri qarkulluese në vlerën e drejtë prej €2.9 milion. Rritja në vlerën e drejtë prej €300,000 (€2.9 milion - €2.6 milion) dërgohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(b) Marrja me qira e pronës do të trajtohet si lizing operacional sepse lizingu është për vetëm 25% (10/40) të jetës së ardhshme të përdorimit të pronës.

Andaj prona duhet të ç'kontabilizohet nga Rea sh.a.

Humbja nga shitja prej €2 milion (€48 milion - €50 milion) nuk duhet të njihet menjehere sepse Rea sh.a është duke u kompensuar nga zvogëlimet e qirasë përgjatë jetës së lizingut. Shuma duhet të trajtohet si parapagim.



Totali i qirave të lizingut përgjatë tërë kontratës është €12.5 milion (5 x €1 milion + 5 x €1.5 milion).

Shpenzimet e qirasë prej €1.25 milion (€12.5 milion x 1/10) do të njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 mars 2018.

Një pjesë e humbjës në shitje do të njihet në fitim ose humbje për vitin e përfunduar me 31 mars 2018.

Shuma e njohur do të jetë €160,000 - [€2 milion x (€1 milion/€12.5 milion)].

Parapagimi në fund do të jetë €1,590,000 (€2 milion - €160,000 + €1 milion (qiraja e paguar) - €1.25 milion (qiraja e ngarkuar)).

(c) Informatat për rënien në vlerë të komponentëve është një ngjarje pas periudhës raportuese sepse ndodh pas datës raportuese por para autorizimit për publikim të pasqyrave financiare.

Kjo ngjarje do të jetë një ngjarje jo-korrigjuese sepse nuk jep informata për kushtet që kanë ekzistuar në datën e raportimit.

Në datën e raportimit, stoqet duhet të maten sipas kostos (€10 milion) apo vlerës neto të realizueshme (€12 milion) cilado që të jetë më e ulët.

Rënia në vlerës e stoqeve pas datës dhe implikimet financiare duhet të shpalosen në shënimet e pasqyrave financiare.

## Problemi 5

Plava sh.a, një kompani e listuar në bursë viti financiar i së cilës përfundon me 31 dhjetor 2017, ka përpara këro çështje të cilat kërkojnë vemendje të menjehershme përpara pasqyrat financiare tu paraqiten drejtorve për aprovim.

a) Plava sh.a bleu një instrument borxhi me 1 janar 2017 në vlerën e drejtë prej €5 milion. Vlera nominale e instrumentit ishte €12 milion me një normë të interesit prej 2.35%. Instrumenti do të maturoj pas tre viteve dhe shuma e ripageshme është €6.25 milion. Norma e interesit në treg ishte 10%. Kostot e transaksionit ishin €400,000. Drejtorët dëshirojnë të masin këtë sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit pasi që ka për qëllim të mbaj instrumentin financiar deri në maturitet. **(5 pikë)**

b) Plava sh.a filloi zhvillimin e një produkti të ri gjatë vitit dhe kapitalizoi €120,000 pasi që përmbushi kriterët për kapitalizim në pajtim me SNK 38. Kjo shumë ishte zbritur për qëllime të tatimit pasi që është shpenzuar. Amortizimi nuk ka filluar pasi që produkti nuk është i gatshëm për shitje. Plava gjithashtu regjistroi provizione gjate vitit aktual prej €80,000 për të mbuluar një obligim për të korrigjuar dëmët që mund të rrjedhin gjatë zhvillimit të produktit të ri. Provizionin nuk është përdorur deri në fund të vitit. Ky shpenzim do të jetë i zbritshëm për qëllime të tatimit kur të paguhet. Norma e tatimit është 25%. **(3 pikë)**

c) Me 31 dhjetor 2017, një nga punonjësit e Plava sh.a është shpërblyer si punëtor më i mirë gjatë vitit dhe i është akorduar e drejta që të zgjedh ose 50,000 aksione në kompani ose të pranojë para në vlerë të 50,000 aksioneve. Data e pagesës është 31 dhjetor 2019 dhe kompania ka vlerësuar se vlera e drejtë e alternativës në aksione është €4 për aksion. Çmimi i aksioneve të Plava sh.a me 31 dhjetor 2017 ishte €3. Nëse punonjësi zgjedh alternative e aksioneve, ai nuk mund t'i shes ato për 4 vite. Drejtorët dëshirojnë të dinë llojet e pagesave të bazuara në aksione sipas SNRF 2 dhe sa do të jetë detyrimi dhe shpenzimet deri me 31 dhjetor 2017 për pagesën e bazuar në aksione më sipër. **(4 pikë)**

d) Me 31 dhjetor 2017, Plava sh.a shiti mallra me vlerë prej €16 milion tek Gucia sh.a. Shuma përmban dy vite të "shërbimeve mbështetese pa pagesë" për produktet. Plava sh.a vlerësoi që kostoja vjetore e shërbimit të produkteve do të jetë €2.4 milion në vit. Plava sh.a në kushte normale fiton një marzhë prej 20% në shitje në këtë lloj të të hyrave nga shërbimi. **(3 pikë)**

### Kërkohet:

Për secilën nga çështjet e listuara më sipër, ju kërkohet që të diskutoni trajtimin në kontabilitet në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe aty ku është e nevojshme, trego se si duhet të shpalosen në pasqyrat financiare të Plava sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. **(total 15 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 5

a) SNK 39 kërkon që pasuritë financiare të maten në njohjen fillestare sipas vlerës së drejtë plus kostot e transaksionit. Investimet e mbajtura deri në maturitet janë instrumente financiare me pagesa fikse apo të paracaktuara dhe maturitet të fiksuar të cilat entiteti ka për qëllim t'i mbaj deri në maturitet.

Drejtorët dëshirojnë ta regjistrojnë duke përdorur koston e amortizuar.

Viti	Kosto e amortizuar në fillim të vitit €000	Të hyrat nga interesi 10% €000	Paraja 2.35% €000	Kosto e amortizuar në fund të vitit € 000
1	5,400	540	(282)	5,658
2	5,658	565.8	(282)	5,941.8
3	5,941.8	594.2	(282)	6,250*

\* Rrumbullaksim

PAGJ për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

Të hyrat financiare €540,000

Pasqyrat e pozitës financiare me 31 dhjetor 2017

Pasuri financiare - MDM sipas koston së amortizuar €5,658,000

b) SNK 12 përdor metoden e provizionimit të plotë për tatimet e shtyera për të gjitha diferencat e përkohshme pa marrë parasysh nëse kompania do të paguaj ndonjëhere apo jo shumë. Diferencat e përkohshme janë diferenca ndërmjet vlerës bartëse të pasurisë apo detyrimit në pasqyrën e pozitës financiare dhe bazës së saj tatimore. Diferencat e përkohshme mund të jene ose diferenca të përkohshme të tatueshme ose diferenca të zbritshme të përkohshme. Kostot e zhvillimit prej €120,000 është kapitalizuar dhe amortizuar përjetë periudhave të ardhshme në përcaktimin e fitimit në kontabilitet por e tërë shuma e kapitalizuar duhet të zbritet në përcaktimin e fitimit të tatueshëm në periudhën që shpenzimet janë paguar.  $(120,000 \times 25\% = 30,000)$ . Pasi që amortizimi nuk ka filluar, vlera bartëse është €120,000 dhe diferenca e përkohshme është gjithashtu €120,000.

Një detyrim shpaloset për provizionet e kostove të ambientit. Sa i përket tatimit, provizioni nuk njihet pasi që rregullat tatimore e njohin vetem kur të paguhet shuma. Një diferencë e perkohshme e zbritshme prej (80,000 x 25% = 20,000) duhet të njihet.

	Vlera barteset	baza tatimore	DPT / (DPZ)
Zhpenzimet e zhvillimit	€120,000	zero	€120,000
Provizionet	(€80,000)	zero	(€80,000)
	€40,000		
PAGJ 31 dhjetor 2017			
Tatimi i shtyrë	€10,000		
PPF 31 dhjetor 2017			
Detyrim i tatimit të shtyrë	€10,000		

c) SNRF 2 përmend 3 lloje të pagesave të bazuara në aksioneve. Ato janë:

1. Të paguara me ekuitet

Një entitet emeton instrumentë të saj të ekuitetit, apo të ndonjë anëtari të grupit të njejtë si konsideratë për mallrat dhe shërbimet e pranuar.

2. Të paguara me para

Një entitet apo një anëtar i grupit të njejtë paguan para duke bërë llogaritjen due e marrë për referencë çmimin e instrumentit të ekuitetit si konsideratë për mallrat dhe shërbimet e pranuar.

3. Me mundësi zgjedhje ndërmjet paguara me ekuitet dhe paguara me para

Furnitori i mallrave dhe shërbimeve apo entiteti që i pranon këto mallra dhe shërbime mund të zgjedhin nëse entiteti duhet të paguaj në para apo të emetoj instrumente të ekuitetit. PBA të dhëna nga Plava sh.a për punëtorin e saj bie në kategorinë (3)

Vlera e aksioneve €4 x 50,000 = €200,000

Alternativa në para €3 x 50,000 = €150,000

Diferenca ndërmjet këtyre dy vlerave paraqet ekuitetin prej €50,000.

Pasi që pagesa e bazuar në aksione është e pakushtëzuar kostot e stafit prej €200,000 (debitohen te PAGJ) dhe €150,000 (detyrim) dhe ekuitet prej €50,000 njihen në pasqyrat financiare me 31 dhjetor 2017. Detyrimi duhet të ri-matet në fund të secilit vit. Ekuiteti mbetet i njejtë (nuk ri-matet).

d) Sipas SNK 18, të hyrat që rrjedhin nga shitja e mallrave duhet të njihen kur kushtet siç janë transferimi i rreziqeve dhe shpërblimeve të mëdha, shitësi nuk mban as kontroll e as nuk përfshihet në menaxhimin e tyre, shumat dhe kostot mund të maten me besueshmëri, përmbushen. Të hyrat e fituara nga dhënia e shërbimeve duhet të njihen bazuar në fazën e kompletimit. Shitja e mallrave tek Gucia sh.a ka dy elemente: shitja e mallrave dhe dhënia e shërbimeve.

Kosto totale e pritur e dhënies së “shërbimit pa pagesë” është €2.4milion x 2 vite = €4.8 milion. Më marzhën normale prej 20% kjo do të jetë €4.8 milion x 100/80 = €6 milion. Andaj për vitin aktual Plava sh.a duhet të njoh të hyra prej €16 milion – €6 milion = €10 milion në datën e shitjes dhe të hyrat nga shitja prej €6 milion duhet të shpërndahen përgjatë 2 viteve.

PPF me 31 dhjetor 2017

Detyrimet afatshkurtëra

Të hyrat e shtyera €3 milion

Detyrimet afatgjata

Të hyrat e shtyera €3 milion